


# STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR

Guillermo Braunbeck, *Menaxher Projekti, Iniciativa e Edukimit SNRF*, BSNK

Pikëpamjet e shprehura në këtë prezantim janë ato të prezantuesit, dhe jo domosdoshmërisht ato të BSNK-së apo Fondacionit të SNRF

© 2013 IFRS Foundation.  30 Cannon Street  |  London

# Përmbajtja



- Përse standarde globale?
- Progresi
- Struktura dhe qeverisja
- Kuptimi i standardeve të bazuara në parime
- SNRF për NVM-të
- Keqkuptime të zakonshme

# Përse standarde globale?

# Krijimi i niveleve në këtë fushë




Standardet globale kontabël do të sigurojnë themelet mbi të cilat do të ndërtohet një sistem më i fortë, më elastik financiar

# Përfitimet e standardeve globale



- Ndarja eficente e kapitalit në rang global
  - tërheqja e investimeve përmes transparencës
  - reduktimi i kostos së kapitalit
  - rritja e investimit në mbarë botën
- Reduktimi i kostove dhe rritja e eficencës
  - lehtëson standardizimin e sistemeve të informacionit
  - eleminon rakordimet e kota
  - eficencë në auditim
  - edukimi dhe trajnimi

# Progresi

# Tregjet Globale: rritje & diversifikim

**Pjesa Vendase në Tregun Global 2001**




**Kapitalizimi i Tregut Global (US$ Trilionë)**



# Progresi drejt standardeve globale kontabël



- 100+ shtete tashmë kërkojnë ose lejojnë SNRF-të
- Prej vitit 2012, **$^{3}/_{4}$ e vendeve të G20 kërkojnë SNRF**

| Anëtarët e G20 që kërkojnë përdorimin e SNRF-ve | Viti i Adoptimit |
|---|---|
| Argjentinë | 2012 |
| Australi | 2005 |
| Brazil | 2010 |
| Kanada | 2011 |
| Bashkimi Europian | 2005 |
| Francë | 2005 |
| Gjermani | 2005 |
| Itali | 2005 |
| Meksikë | 2012 |
| Republika e Koresë | 2011 |
| Rusi | 2012 |
| Afrika Jugore | 2005 |
| Turqi | 2005 |
| Mbretëria e Bashkuar | 2005 |

# 500 trendet raportuese të Fortune Global






*ose termi ekuivalent

Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

# Struktura dhe Qeverisja

IFRS™

# Vizioni



… një grup i vetëm i standardeve globale kontabël të cilësisë së lartë..

..të përdorura në tregjet globale të kapitalit.

# Themelet e Zhvillimit të SNRF-ve



# Si funksionojmë?



- Një bord i pavarur hartues i standardeve
- I mbikqyrur nga një organ i larmishëm i të besuarve
- Publikisht i përgjegjshëm ndaj një Bordi Monitorimi të autoriteteve të tregut të kapitalit
- Punon në interes publik




IFRS™

# Procesi i hartimit të standardeve



# Përdorimi i SNRF-ve – idealja



**Në mënyrë ideale, adoptimi i SNRF-ve si kuadër raportues:**

- SNRF siç janë nxjerrë nga BSNK në mënyrë të plotë
- Raporti i auditimit dhe shënimi shpjegues i bazës së paraqitjes i referohen SNRF-ve
- Pa “miratim” vendor

**Përdorimi i SNRF-ve nënkupton të gjitha standardet dhe interpretimet e tyre**

- Ndonjëherë është e vështirë të arrihet idealja

IFRS™

Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

# Kuptimi i standardeve të bazuara në parime

IFRS™

# Çfarë do të thotë të bazuara në parime?



- Mbështetje e madhe u jepet standardeve kontabël të bazuara në parime
- Por, cfarë do të thotë të bazuara në parime?

## Në këtë prezantim

- një kërkesë e SNRF-ve bazohet në parime vetëm kur është konsistente me konceptet e dhëna në *Kuadrin Konceptual* të BSNK-së.

# Të kuptuarit e SNRF-ve bazuar në Kuadrin…



- lidh çdo kërkesë të SNRF-ve me konceptet në *Kuadrin Konceptual*
- kuptohet pse disa nga kërkesat e SNRF-ve nuk i maksimizojnë ato koncepte (p.sh. aplikimi i kufizimeve të kostos)



**Koncepte**



**Parime**



**Rregulla**

© IFRS Foundation. 30 Cannon Street | London EC4M 6XH | UK. ëëë.ifrs.org

# Të kuptuarit e SNRF-ve bazuar në *Kuadër* ofron…



- një kuptim koheziv të SNRF-ve
  - *Kuadri* lehtëson formulimin konsistent dhe logjik të SNRF-ve
- bazën për gjykim në zbatimin e SNRF-ve
  - *Kuadri* themeloi konceptet që përbëjnë bazamentin për vlerësimet, gjykimet dhe modelet mbi të cilat bazohen pasqyrat financiare sipas SNRF-ve.
- bazën për përditësimin e vazhdueshëm të njohurive mbi SNRF-të dhe kompetencave të SNRF-ve

# Roli i *Kuadrit Konceptual*



- **BSNK** përdor *Kuadrin* për të vendosur standardet
  - rrit konsistencën ndërmjet standardeve
  - rrit konsistencën në kohë edhe pse anëtarët e Bordit ndryshohen
  - ofron pika referimi për gjykim
- **Komiteti i Interpretimeve të SNRF-ve** përdor *Kuadrin* për të interpretuar SNRF-të kur nuk ka kërkesë të dhënë nga SNRF-të
- **Përgatitësit** përdorin *Kuadrin* për të zhvilluar politikat kontabël në mungesë të një standardi specifik
  - Hierarkia e SNK 8

# *Kuadri Konceptual* i BSNK-së



- *Kuadri* përcakton konceptet e rëna dakord të cilat theksojnë raportimin financiar sipas SNRF-ve
  - objektivi i raportimit financiar me qëllim të përgjithshëm
  - karakteristikat cilësore
  - elementët e pasqyrave financiare
  - njohja
  - matja
  - paraqitja dhe shënimet shpjeguese

Konceptet e tjera rrjedhin të gjitha nga objektivi

# Objektivi i raportimit financiar



Të sigurojë informacion financiar mbi njësinë ekonomike raportuese që është i dobishëm për investitorët ekzistues dhe potencialë, huadhënësit dhe kreditorët e tjerë në marrjen e vendimeve në lidhje me ofrimin e burimeve për njësinë ekonomike

# Objektivi i raportimit financiar



- Pritshmëritë e investitorëve, huadhënësve dhe kreditorëve të tjerë në lidhje me kthimet varen nga vlerësimi i shumës, afatit dhe pasigurisë për (perspektivat për) **hyrjet e mjeteve monetare të ardhshme neto** në njësinë ekonomike.
  - Vendimet e investitorëve në lidhje me blerjen, shitjen apo mbajtjen e kapitalit dhe instrumentave të borxhit varen nga kthimet e pritshme mbi investimin në ato instrumente, p.sh. dividendët, pagesat e principalit dhe të interesit ose rritja e çmimit të tregut.
  - Vendimet e huadhënësit për të ofruar apo shlyer huatë dhe forma të tjera të kredive varen nga pagesat e principalit dhe të interesit ose nga kthime të tjera të pritshme.

IFRS™

Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar




# SNRF për NVM-të

IFRS™

# SNRF për NVM-të



**Raportim i Mirë Financiar i Thjeshtëzuar.**

- 230 faqe
- SNRF të thjeshtëzuara, por të ndërtuara mbështetur në SNRF
- Të hartuara specifikisht për NVM-të
- Të njohura ndërkombëtarisht
- Përshtatur për NVM-të
  - nevojat e përdoruesit për informacion mbi fluksin monetar
  - kostot dhe aftësitë e NVM-ve

# A janë të veçuara apo të lidhura me SNRF-të e plota?



## Terësisht të veçuara

- Rasti i vetëm  ku të qenit 'e veçuar' nga SNRF-të e plota nuk aplikohet është opsioni i përdorimit të SNK 39 në vend të seksioneve të instrumenteve financiare të SNRF për NVM-të

# Pse një NVM duhet ta adoptojë atë?



- Përmirësimi i aksesit në kapital
- Përmirësimi i krahasueshmërisë
- Përmirësimi i cilësisë së raportimit krahasuar me PPPK ekzistuese kombëtare (Parime Përgjithësisht të Pranuara të Kontabilitetit)
- Më pak barrë aty ku SNRF-të e plota ose PPPK-të e plota kombëtare kërkohen
- Operacionet shumëkombëshe
  - sisteme kompjuterike të standardizuara
  - procedura të thjeshtëzuara konsolidimi
  - trajnime të standardizuara

IFRS™

# Ndërmarrje të vogla dhe të mesme



- jo të përgjegjshme publikisht
  - borxhi i tregtueshëm/instrumente kapitali (tregu publik), ose
  - aftësia për të mbajtur aktivet me cilesinë e 'të besuarit' (grup i gjerë i palëve jashtë njësisë) si një nga bizneset e saj parësore
- publikimi i pasqyrave financiare me qëllim të përgjithshëm për përdoruesit e jashtëm

# Q&A: Ndërmarrjet që përgjithësisht kanë përgjegjësi publike



Bankat, unionet e kreditit, shoqëritë e sigurimeve, tregtarët/agjentët e letrave me vlerë, fondet e përbashkëta dhe bankat e investimeve janë "tipikisht" NVM.

A do të thotë kjo se të gjitha njësitë ekonomike të këtyre llojeve duhet automatikisht të konsiderohen me përgjegjesi publike?

**Jo. Nevojitet gjykim në vlerësimin nëse njësitë ekonomike të këtyre llojeve kanë përgjegjësi publike.**

Shembuj:

- Filiale sigurimi të përfshira
- Fonde investimi me vetëm disa pjesëmarrës

Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

# Keqkuptimet e zakonshme

# Keqkuptimet e zakonshme



| Kuadri nuk... | Por, Kuadri përfshin… |
| --- | --- |
| përfshin konceptin e përputhshmërisë | kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara—njeh elementet kur plotësohen përkufizimet dhe kriteret e njohjes |
| përfshin konceptin e konservatorizmit | konceptin e neutralitetit |
| përfshin elementin e të ardhurave gjithpërfshirëse (ose konceptin e OCI) | vetëm elementët e mëposhtëm—aktivi, pasivi, kapitali, të ardhurat dhe shpenzimet |
| përmend qëllimin e menaxhmentit ose modelin e biznesit | |

IFRS™

# Keqkuptimet e zakonshme vazhdim



| Keqkuptimet | Sqarimet |
|---|---|
| Parimet domosdoshmërisht janë më pak rigoroze sesa rregullat | Rregullat janë mjetet e inxhinierëve financiare |
| Ka pak gjykime dhe vlerësime në matjet e bazuara në kosto | Inventari, p.sh. shpërndarja e kostove të përbashkëta dhe shpenzimeve indirekte të prodhimit<br><br>AAM, p.sh. kostot për çmontimin /restaurimin e vendit, jeta e dobishme, vlera e mbetur, metoda e amortizimit<br><br>Provizionet, p.sh. afate kohore të pasigurta dhe shuma e flukseve të pritshme të ardhshme të mjeteve monetare |

IFRS™

# Faleminderit






© IFRS Foundation.  30 Cannon Street | London EC4M